



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Nr. 57/2020  
Datë: 20.05.2020

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë, bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L-031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, në takimin e mbajtur me datë 20.05.2020, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr.57, të datës 07.05.2020, nga Kompania **Matkos Pharm**, me seli në Prishtinë, me adresë: Rr.Shpetim Robaj nr.289, me person përgjegjës **Qendrim Kopalla**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të datës 23 Mars të publikuar, nxjerr:

**V E N D I M**

**HUDHET POSHTË si e pa afatshme**, kërkesa për rishqyrtimin e çmimeve e parashtruar nga Kompania **Matkos Pharm** me seli në Prishtinë, adresa Rr. Shpetim Robaj nr.289.

**Arsyetimi**

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, konstatoi se vendimi për përcaktimin e çmimeve është publikuar me datë 23.03.2020, afati i ankesave ka qenë 8 ditë nga data e publikimit të listës së çmimeve, që i bie deri me datën 31.03.2020 ndërsa ankesa e palës është pranuar me datë 07.05.2020, jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë të ankesë në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë, në afat prej 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit të vendimit.

Vendim i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. AKKPM-së

Dr. Naïm Bardiqi

Kryesuesi i Komisionit

